



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. 1118 Prot.

Përmet më, 08 . 05 .2018

NJOFTIM

**PËR
ÇDO TAKSAPAGUES
QË ËSHTË PRONAR APO PËRDORUES
I PASURISË SË PALUAJTSHME E LLOJIT “NDËRTESE”**

Me anë të këtij njoftimi po ju drejtohem të gjithëve Ju taksapagues që jeni pronarë apo përdorues të pasurisë së paluajtshme të llojit “ndërtesë” për qëllime banimi apo për të ushtruar veprimtari tregëtare për të bërë vetëdeklarimin sipas VKM nr.132 datë 07.03.2018“ Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksë”, neni 2 pika 1.1. VETËDEKLARIMI :

“ Çdo taksapagues duhet të vetëdeklarojë të dhënat për pasurinë e tij të pluajtshme ndërtesë/njësi pronësore që ka në pronësi apo përdorim”

Vetëdeklarimi bëhet pranë Bashkisë Përmet ,Zyrës së Taksa Tregjeve apo pranë Njësive Administrative .

Ju faleminderit!

ZYRA E TAKSA-TREGJEVE

